



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 82/12
Prishtinë, më 07.11.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Duda Balje, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Sevdije Lama.

Mungoi: Albana Fetoshi.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Bedri Hamza Ministër i Financave, Agim Krasniqi Drejtor i Departmanetit Ligjor në MF, Lulzim Rafuna Drejtor i Departamentit Ligjor në Doganat e Kosovës të MF,

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli, dhe Albulena Gashi (praktikant).

Gjithashtu ishin të pranishëm:Rejhane Zylfijaj Ramadan Islami (GIZ),

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;**
3. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
5. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës njëzëri miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryetarja theksoi se projektbuxheti i vitit 2013 është dorëzuar në Kuvend në afatin e kohor ashtu siq është parapa me ligji. Shifet se projektbuxheti është bazuar në analizat makroekonomike dhe në planin të cilin e ka qeveria për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Janë bërë harmonizimet me FMN-në dhe i është kushtuar një kujdes i posaçëm politikës makrofiskale dhe buxheti është i përgaditur brenda kornizave të cilat janë përcaktuar dhe duke i marr parasysh edhe rreziqet e ndikimet aktuale ne eurozonë dhe në vendet tjera të rajonit. Nëse analizojmë draftbuxhetin, shohim se ka projekte të reja të cilat reflektojnë direkt ne zhvillimin ekonomik, si dhe rritje te buxhetit për komunat. Po ashtu buxheti në aspektin teknik është shumë më nivel se sa vitet e kaluara dhe duhet vlerësuar se vazhdimisht po ngriten kapacitete në përgatitjen e detalizuar të buxhetit. Projektbuxhetit i është bashkangjitur pjesa tekstuale dhe pjesa tabelare dhe kemi të përfshirë edhe treguesit makroekonomikë, buxheti shifet se është referuar edhe KASH.

Bedri Hamza njoftoi se procesi buxhetor për vitin 2013, ka qenë i rregullt dhe ka startuar në fillim të vitit me nxjerrjen e indikatorëve makroekonomik pastaj u lëshua qarkorja e parë buxhetore e cila është pasuar me qarkoret vijuese. Projektbuxheti u diskutu ne tri misionet e FMN dhe përfundimisht kemi ardhur në harmonizim të plotë më FMN-në. Projektbuxheti është përgaditur bazuar në LMFPP dhe gjatë hartimit të buxhetit e kemi marr në trajtim edhe ambientin e jashtëm dhe ndikimet negative në eurozonë që mund të ketë efektin e vet në Kosovës që aktualisht është i kufizuar dhe kryesisht vërehet në pjesën e eksporteve. Duke u bazuar në këto rrethana ne kemi projektuar të hyrat buxhetore. Të hyrat rrjedhëse duke përjashtuar financimet e njëhershme prej 1 miliard 423 milion dhe të hyrat janë planifikuar të rriten rreth 6.8% apo e rreth 91 milion euro më shumë se në vitin e ardhshëm, nuk kemi grant të bankës botërore dhe dividenda do të jetë në nivel më të ulët. Jemi dakorduar me FMN që deficitin primar buxhetor të jetë në lartësi prej 155 milion që është afërsisht rreth 3% e GDP dhe do të jetë i mbuluar më shumë se 100%. Presim që në fund të vitit 2012 të kemi një bilanc bankar pozitiv të lirë të shpërndarjes që do të jetë rreth 203 milion i cili është i mjaftueshëm për mbulimin e deficitit për vitin e ardhshëm. Rritja ekonomike për vitin e ardhshëm vlerësohet që të jetë 4.5%, ndërkaq FMN ka një projeksion pak më konservativja i përket rritjes ekonomike do të jetë mbi 3% dhe Banka Botërore del me projeksion se rritja ekonomike për vitin e ardhshëm do të jetë diku rreth 4.1%. Impaktin më të madh në rritjen ekonomike do ta kenë konsumi, investimet dhe eksportet. Më pas ministri prezantoi shpenzimet buxhetore, ku theksoi se kemi një rritje për të gjitha kategoritë ekonomike. Ky buxhet reflekton prioritetet e Qeverisë, mundëson përfundimin e autostradës Morinë-Merdarë sipas kontratës që pritet të përfundoj në vitin 2013 dhe për këtë projekt janë të buxhetuar për ekzekutimin e projektit rreth 217 milion euro. Është arritur pajtim edhe FMN që të futet edhe projekti i ri “autostrada Prishtinë-Shkup”. Për ekzekutimin e projektit në këtë buxhet fillestar është planifikuar rreth 30 milion euro, janë disa parakushte për zhvillimin e këtij projekti, e para kërkohet që të përfundohet fizibiliteti i këtij projekti në konsultim me Bankën Botërore. Dhe përveç studimit të fizibilitetit, kërkohet që bilanci bankar në momentin e nënshkrimit të kontratës të jetë në nivel 300 milion euro, por nuk caktohet mënyra se si do të arrihet kjo shumë. Nuk kemi paragjykuar fundin e procesit të privatizimit të PTK-së dhe projektet të cilat janë brenda buxhetit 2013 nuk janë të lidhura me përfundimin e këtij procesi. Janë ndarë mjete edhe për vazhdimin e punimeve për rrugën Prishtinë-Pejë dhe për vazhdimin e punimeve për rrugën Prishtinë-Mitrovicë që janë 16 milion nga buxheti, jemi në diskutim e sipër me Bankën Islamike për Zhvillim që të vijjnë edhe 30 milion \$ që do të përdoren për financimin e këtij projekti. Shifet po ashtu se ka edhe numër të konsiderueshëm të projekteve edhe ka fonde edhe për mirëmbajtjen e rrugëve, numër të konsiderueshëm të projekteve që janë të shtrirë nëpër komuna dhe e themë me përgjegjësi se nëse i shikojmë me kujdes është i përfshirë i gjithë territori i Republikës së Kosovës. Përmes këtij projektbuxheti mbulohet kostoja e reformave në shëndetësi, dhe është mbuluar kostoja e reformave në administratën publike mundësohet përfundimi i dhjetëra objekteve shkollore dhe një numër i ri i objekteve shkollore, mundësohet përfundimi i numrit të konsiderueshëm të palestrave sportive ,mundësohet vazhdimi i granteve për sektorin e bujqësisë

dhe nga ky projektbuxhet ka fituar rritje edhe sektori i sigurisë. Te pjesa e komunave, komunitat kanë përfutur buxhetin sipas kriterëve që janë për menaxhimin e financave publike, dhe regjistrimi i fundit i popullsisë nuk ka reflektuar në buxhetin e vitit 2013. Komunitat për herë të parë e fitojnë të drejtën për shpërndarjen e të hyrës vetanake sipas prioriteteve që i ka komuna.

Kryetarja nga prezantimi po shifet se objektiva të cilat i ka paraparë qeveria janë të ristrukturuar në brendi të buxhetit.

Hykmete Bajrami njoftoi se si grup i LDK-së dhe si dhe grup parlamentar kanë analizuar projektbuxhetin e vitit 2013 dhe kemi ardhur në përfundim se ky buxhet ka të njëjtën bazë sikurse buxheti i vitit 2011 dhe 2012. Ne mendojmë edhe besojmë në bazë të asaj se çka është prezantuar këtij drafti i mungojnë elementet zhvillimore dhe nuk mbështetet në asnjë objektiv makroekonomike. Është buxhet shpenzues me përqindje të madhe të investimeve në vetëm një rrugë që në fakt nuk po i jep efektet e saj ekonomike. I vetmit presupozimi saktë është se ajo qfarë do të konsumojnë kosovarët gjatë vitit 2013, do të vije kryesisht nga importi, kjo vërtetohet nga fakti se 64% e të hyrave të përgjithshme të buxhetit vijnë nga dogana. Edhe për të tretin vit me rradhë qeveria ka vendosur në buxhet të hyra të njëhershme që aludohet me privatizimin e PTK-së dhe kjo bënë që ¼ e buxhetit të bazohet në të hyra fiktive që nuk dihet se a do të vijnë?. Risja e këtij buxheti është ndarja e 30 milion eurove për “Autostradën Prishtinë-Shkup” realizimi i së cilit projekt është kushtëzuar me një nen, i cili parasheh se për të filluar ky projekt bilanci bankar duhet të jetë 300 milion euro. dhe sa i përket kësaj qeverie asnjëherë në historinë e vet bilancin bankar 300,000.00 euro nuk e kanë pasur, mirëpo edhe sikur ky bilanc të arrihet atëherë kjo do të mjaftoj sa për fillimin e projektit dhe më së shumti do të asfaltohen 3 km rrugë. U tha se në buxhet kemi një rritje prej 4% të shpenzimeve dhe kemi një rritje prej 2.8% të të hyrave, këtu patjetër duhet cekur se sapo e kemi aprovuar buxhetin e vitit 2012 qeveria ka pas vështirësi në ekzekutim të buxhetit edhe ka ardhur me listën ku 85 projekte kapitale janë shkurtuar dhe si rezultat i atij shkurtimi që ka ndodhur vitin e kaluar ne kemi plot projekte që nuk kanë mundur të realizohen në këtë vit dhe parashihet që të vazhdojnë në vitin 2013. Problemet strukturore janë deficitin i lartë i cili faktikisht është mbi normën e lejuar me normat evropiane, dhe ne nuk e shohim që ky projektbuxhet po reflekton KASH-in. Normat për rritjen ekonomike nga 8% që vjen nga plani Banskë kanë ra nën 4.5 % do të thotë zbritja e papunësisë ka mbetë vetëm një premtim. Investimet kapitale prej 621 milion mbesin pothuajse në të njëjtin nivel, ajo çka na brengos është që 35% të tyre shkojnë vetëm në një rrugë do të thotë që shkojnë vetëm për Bechtel-Enka që dalin jashtë Kosovës. E kemi në buxhetin për paga shumë prej 25 milionëve, por nuk parashihet rritje për pagat për ndonjë kategori pavarësisht që kemi pasur premtime të shumta gjatë këtij viti dhe nëse i shohim projeksionet për vitet 2014-2015 faktikisht nuk do të ketë rritje të pagave dhe inflacioni që ka ndodhur gjatë këtyre viteve e kemi parë që e ka absorbu komplet rritjen e pagave. Mallrat dhe shpenzimet, buxheti është rritur në 225 milion euro mirëpo duke ditur gjendjen alarmante në spitale dhe shkolla etj, nuk besoj që qytetarët e Kosovës mund të presin shumë. Subvencionet dhe transferet janë rritur prej 9% këtu kisha pasur një pyetje që a reflekton kjo rritjen e pensioneve që janë premtuar të fillojnë prej 1 janarit të vitit 2013, nëse po atëherë me këtë rritje 9% kategoritë tjera a do të mbesin të paprekura dhe kjo është një rritje simbolike sepse e kemi numërin e madhë të qytetarëve të varfër në Kosovë? Ministri tha që janë alokuar 217 milion, aty e shohim se në projeksionet nuk ka buxhet të alokuar për vitin 2014 -2015. A përfundon autostrada apo do të ndërprehet autostrada pasi që të vijë në Prishtinë sepse në paralogarit është e pabesueshme që 217 milion euro do të mjaftojnë për përfundimin e projektit deri në Merdarë? Shpenzimet kapitale kryesisht janë projekte që përcillen nga vitet e kaluara, pastaj na brengos shumë buxheti shumë i vogël për Ministrinë e Bujqësisë përkundër faktit që 60 % e popullsisë jetojnë në zona rurale. Te Ministria e Tregtisë projektet kapitale nga 4.3 milion në 2012 kanë ra në 2.5 milion, ndoshta kjo është e mirë sepse ata nuk kanë bërë asgjë përveç disa reklamave skandaloze në CNN. Kur flasim për Ministrinë e Punës, në divizionin për punësim i cili promovon krijimin e vendeve të reja vetëm 50 000 euro janë si projekt i ri dhe nuk shërbejnë as për të bërë anketën e papunësisë për të pasur një numër të saktë sesa janë të papunë. Në fushën e arsimit vetëm 2.3 milion janë projekte të reja të tjerat janë

shkolla që kjo qeveri i ka filluar qysh në vitin 2010 edhe spo i'a del asesi që t'i përfundoj. Në shëndetësi kemi vetëm 1.8 milion projekte të reja, ndërsa në infrastrukturë 72% të investimeve kapitale në shkojnë për Bechtel-Enka, ndërsa sa i përket mjedisit parashihen investime vetëm 5.3 milion, që është e vogël se vitin e kaluar që po shihet se mbrojtja e ambientin nuk është ndonjë prioritet. Pyeti Ministrin se ngritja e buxhetit për paga 5 milion euro cilat kategori i prek? Te subvencionet e transferet a janë komplet të dedikuara për rritjen e pensioneve? Për rrugën Prishtinë-Pejë kanë qenë të programuara 18 milion dhe ky buxhet ka ra në 6 milion euro?

Bedri Hamza duhet vlerësuar konstatimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, sidomos për pjesën makrofiskale që thuhet se 40% e totalit të buxhetit të shkon në investime kapitale edhe mos të ketë impakt në zhvillimin ekonomik kjo nuk qëndron, pasi që jo vetëm investimet kapitale por edhe konsumi ka impakt në zhvillimin ekonomik e investime kapitale. Të hyrat e njëhershme në nuk paragjykojmë përfundimin procesit të privatizimit dhe bilanci bankar do të jetë pozitiv dhe të gjitha projektet do të arrihen të financohen në mënyrë të qëndrueshme. Projekti i Autostradës Morinë-Merdarë i rëndësisë nacionale të zhvillimit ekonomik dhe në interes të qytetarëve dhe sigurisht se ky projekt do të fillojë gjatë vitit 2013. Sa i përket deficitit kemi harmonizim të plotë me FMN- në se është i mbuluar 100%. Sa i përket pensioneve brenda pozicionit subvencioneve edhe transfere është e paraparë shuma për mbulimin e kostos dhe vendimit të qeverisë për rritje të pensioneve. Autostrada Morinë Merdarë, do të financohet sipas kontratës së nënshkruar dhe janë ndarë mjetet e mjaftueshme për finalizimin e projektit deri në Besi. Sa i përket fondeve për ministrin e bujqësisë ka rritje signifikante në total të ndarjes së fondeve për këtë sektor, për këtë jo vetëm brenda buxhetit por ne do ti marrim në total fondet që priten të investohen në këtë sektor në nivelin qendror dhe lokal. Buxheti për Ministrinë e Bujqësisë është 40 milion €. Janë ndarë mjete për arsim për 30 objekte shkollore, po ashtu 10 milion euro për reformën në administratën publike. Jam shumë i sigurt edhe për 2013 që deficitin real në Kosovë do të jetë rreth 2%. Një çështje që ne nuk e kemi bërë pjesë të hyrave të buxhetit të Kosovës dhe mund të vijë në Kuvendin e Kosovës, janë të hyrat nga procesi i likuidimit të ndërmarrjeve të privatizuara. Nuk kemi planifikuar për vitin e ardhshëm mjete nga FMN dhe nuk ka grante nga Banka Botërore, 80 milion euro janë si huazim i brendshëm si dhe të hyrat nga emitimi i letrave me vlerë.

Kryetarija një çështje që ngriti Hykmetja dhe në bazë të sqarimeve që ofruat ministër, nëse unë arrita t'i evidentoj mirë që ¼ e buxhetit bazohet në të hyrat fiktive, dhe kjo nëse një shifër e tillë del në këtë mënyrë krijon dyshime se çka po ndodh me të hyrat e buxhetit.

Bedri Hamza sa i përket pyetje së Kryetares sqaroi se i kemi të hyrat e rregullta të buxhetit që janë 1 miliard e 423 milion euro që bazohen në të hyrat rrjedhëse, të hyrat e njëhershme i kemi 26.3 milion që pritet të vijnë nga finalizimi i kontratës për distribucione dhe rreth 300 milion euro që ne nuk i kemi paragjykuar se cila do të jetë vlera. Megjithatë edhe nëse i heqim 300 milion euro të përlllogaritura, praseprap bilanci bankar do të jetë 126 milion plus nën supozimin e shpenzimit të buxhetit 100 %.

Hykmete Bajrami nuk mund të thoni se buxheti nuk bazohet në të hyrat e pasigurta, kur pjesë e tabelës 1 janë paraparë edhe rreth 326 milion euro të hyra të njëhershme. Nëse do të hiqej dispozitat që kufizon këtë shumë nuk do të ishit në pajtim me FMN për autostradën Prishtinë-Shkup apo një sërë projektesh tjera që ndërliidhen me të hyrat e njëhershme. U tha që 40 % të buxhetit shkon për investimeve kapitale dhe kjo, ka efekt në rritjen ekonomike, por investimet në asfalt kanë treguar që nuk ka efekte multiplikuese, nuk janë krijuar vende të reja të punës, varfëria vetëm është rritur. Të hyrat nga likuidimi keni bërë shumë mirë që nuk i keni këtu sepse unë mendoj se që për të hyrat nga procesi i privatizimit nga procesi i likuidimit duhet të vendos Kuvendi.

Bedri Hamza Qeveria është përcaktua që prioritet e ka ndërtimin e autostradës Morinë-Merdarë dhe kontrata nuk është ndryshuar ,dhe e kemi prioritet autostradën Prishtinë-Shkup. Sa i përket qëndrueshmërisë po e ritheksoj se projektet që janë të parapara në buxhetin e vitit 2013 janë të bazuara në të hyra qëndrueshme. Nëse përfundon shtija e PTK-së, bilanci bankar do të jetë 426 milion euro apo më i lart e nëse nuk përfundon do të jetë bilanci bankar prapë i atillë që mundëson përfundimin e të gjitha projekteve dhe garanton likuiditetin dhe stabilitetin makrofiskale.

Sali Asllanaj struktura e buxhetit gjithmonë është e njëjtë për 3 vjet pothuajse është e njëjtë dhe realisht edhe ne na bie që të përsërisim shumë fjalët. Është e vërtetë që Ministria e Financave po i'a dilni mbanë disi me fillue projekte të mëdha për të cilat Kosova nuk ka kapacitet dhe sinjerisht i kishim thënë mjaftë më autostradës, do të gjejmë variante të reja të rrugëve. A ka mundësi ekonomike një Kosovë e lodhur të jap kaq shumë mjete për një autostradë, a ka efekte multiplikuese zhvillimin ekonomik,nuk jam ekspert por e di që nuk ka mundësi të ketë kur të gjitha mjetet derdhen jashtë vendit, i merr Bechtel-Enka? Bie në sy që shumë projekte janë ato që janë planifikuar para katër vitesh, si rasti në Therandë që kur kam qenë kryetar i komunës, sot i kemi ende në buxhet. Unë mendoj që kishte me qenë fat i mirë që 30 milion euro që keni paraparë për Shkup merrni dhe investoni në bujqësi dhe do të jetë puna më e mençur e mundshme.

Naser Osmani nuk do të hyj në numra të buxhetit sepse ndarja bëhet sipas prioriteteve që qdo subjekti që vjen edhe i përcakton dhe këtu dallojnë partitë politike prioritete buxhetore. Atë që e kam vërejtur në pjesën tekstuale ka të bëjë më nene që është me rëndësi më duket që këtë herë është më i kompletuar më i qartë nuk jep shumë dilema me përjashtim te kjo që ka të bëjë me pagesat e paradhënies ku përmendet komisioni për buxhet dhe financa, që është një risi. Ajo që ka të bëjë me rrugën 6 të autostradës për Shkup që është ai kushti që bilanci bankar të jetë 300 milion. Mendojë që sqarimet në tabelën 1 do të duhej të ishin me të detalizuara për qdo pozicion të jipen sqarime me fjalë që ta kuptojnë deputetët e tjerë çka do të thotë këto huazimet e brendshme,me sqaruar kujt do t'i jipen,cilave ndërmarrje publike apo kthimi nga ndërmarrjet publike,cilat ndërmarrje publike i kanë borxh buxhetit të Kosovës, sa është ai borxh? Fatkeqësia jonë e trashëguar se ne jemi të varur shumë prej importeve edhe këto importe ndikojnë drejtpërdrejt në të hyrat buxhetore që po reflekton në mënyrë automatike në zhvillimin ekonomik të vendit. Na mungon një ent statistikor i mirëfilltë në Kosovë që ne ishim shërbyer me ato të dhëna për planifikime sa më të mira ,ne nuk e kemi më tepër po bazohemi në ato analiza që po na i jep Banka Qëndrore. Ajo që e përmendi deputetja që edhe mua më ra në sy ishte çështja e dallimit në paga te ai 20 milionëshi, a bëhet fjalë për punësime të reja? Ajo që mua më brengos është që në vitin e ardhshëm ne kemi zgjedhje lokale dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në zgjedhjet lokale sidomos në investimet kapitale që kanë të bëjnë nëpër komuna dhe unë këtë e vëreje një dallim por mundësia e përmirësimit është gjithmonë përmes bashkëpunimit në procesin e amendamentimit të ligjit. Unë i'u kisha lut deputetëve që në kohën e amendamentimit është që të gjejnë mundësin e një bilanci të investimeve nëpër komuna, bile për pjesën e mjeteve që janë pjesë e qeverisë, përndryshe politikisht duhet të them jo.

Xhevdet Neziraj vlerësoi përgatitjen e buxhetit nga ana teknike që është shumë më lehtë edhe të gjendemi me numra. Nuk është mirë fakti që shumica e të hyrave janë prej doganave dhe do të ishte mirë që të kemi të hyrë më të shumta prej tatimeve apo të hyra të brendshme, por këto janë mundësit e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Pa pasur një rritje të madhe të themi prej 70 % nuk do të ketë një zvogëlim radikal të papunësisë në Kosovë dhe këtë nuk e ka arritur as kjo qeveri dhe as qeveritë e mëparshme dhe dhashtë zoti qeveritë e ardhshme do të arrijnë këtë rritje. Po e shoh se në departamentin e industrisë dhe te ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është ndarë një buxhet pak më i vogël dhe mendoj se është dashur të koncentrohen mjete më shumë me qëllim të hapjeve së vendeve të reja të punës dhe stimulimit të atyre ndërmarrjeve. Interesohem më tepër rreth rrugës Prishtinë-Pejë që janë 16 milion euro, se si do të shkoj kjo me detaje realizmi i këtij projekti.

Naser Osmani pyeti sa ndikon marrëveshja e Cefta-s në buxhet? Ne e kemi të qartë se si ndikon në ekonomi edhe po e shohim se çka po ndodh edhe përkundër asaj që janë anëtar, disa shtete bëjnë disa ndalesa që dëmtohet tregu i Kosovës dhe ne nuk reagojmë.

Bedri Hamza sa i përket pagave, janë kryesisht reflektim i tri çështjeve: e para reformat në administratën publike që kanë të bëjnë me implementimin e ligjit për shërbyesit civil dhe akteve nënligjore, për të cilën kemi ndarë 10 milion euro. E dyta, kemi rritje të numrit të punësuarve në Universitetet publike, sidomos në Universitetin e Pejës dhe atë të Prizrenit. Dhe e treta kemi rritje të të punësuarve në sektorin e drejtësisë, gjyqësor, rritje të numrit të të punësuarve në sektorin e shëndetësisë, këto janë si rezultat i rritjes së pozicionit për pagan në buxhetin e vitit 2013. Ndikimi i CEFTA-s në buxhet është negativ. Si rezultat produktet e prodhuara brenda Bashkimit Evropian në raport me produktet e prodhuara prej vendeve pjesë të Cefta-s. Interesi i Ministrisë së Financave është që produktet e prodhuara brenda vendeve të Bashkimit Evropian t'a kenë trajtimin e njëjtë me produktet e vendeve të Cefta-s, për këtë kemi biseduar edhe me FMN-në. Kjo do të reflektoj me humbje të të hyrave në buxhetin e Kosovës si rezultat i reduktimit dhe eliminimit të doganave, dhe kjo mund të kompensohet me një ngritje të lehtë të TVSH-ës që do të kompenzohen të gjitha humbjet që do të shkaktohen si rezultat i eliminimit të doganës për produktet e BE-së. Ne e kuptojmë rritjen e konkureshmërisë, lëvizjen e lirë, e të gjitha por ne duhet të ecim tutje dhe të krijojmë ambient të përshtatshëm ku fillimisht prodhuesit vendor do të ndihen komod dhe konkurrent në treg dhe pastaj edhe vendet e BE-së të jenë të barabarta me vendet e CEFTA-s.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni me Shtatë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Sevdije Lama), dy Kundër (Naser Osmani dhe Hykmete Bajrami) dhe një Abstenim (Xhevdet Neziraj) nxori këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Kryetarja theksoi se është projektligj që rregullon dhe përcakton mallrat të cilat lirohen nga tatimi doganor dhe që mund të lëshohen me qarkullim të lirë me shkallë zero të tatimit doganor për arsye të natyrës së mallit dhe për arsye të përdorimit të tyre të veçant. Qëllimi i lirimit nga taksat doganore është në funksion të përmbushjes së obligimeve me qëllim të krijimit të kushteve për nënshkrimin e marrëveshjeve tregtare me BE-në si dhe stimulimit të prodhimit vendor. Miratimi i këtij projektligji poashtu ka një refleksion në koston buxhetore siq e kemi vërejtur nga projektligji është diku rreth 5 milion euro.

Bedri Hamza sqaroi se qëllimi i projektligji është të ndihmojë kompanitë që të eksportojnë shërbime si dhe të bëjnë nxitjen e zëvendësimeve të produkteve të importuara me produktet e prodhuara në vendin tonë, nxitjen e punësimit dhe rritjen e mirëqenies qytetare. Do t'i mundësohet sektorit privat zhvillim të qëndrueshëm, posaçërisht sektorit të cilat janë në zhvillim e sipër. Më pas ministri përmendi disa nga lëndët dhe produktet kryesore që do të lirohen nga tatimi doganor më e të cilat janë të paraparë në anekset e këtij projektligji. Kemi liruar edhe sistemin e ujitjes së tokës, poashtu si rezultat i marrëveshjes së tregtisë së lirë që ka lidh Kosova me shtetet tjera është vërejtur një kategori e produkteve finale të cilat nuk i shtrohen tatimit doganor gjatë importimit. Poashtu kemi marr vendim që t'i lirojmë nga tatimet doganore një grup produktesh farmaceutike që kryesisht gjejnë aplikim nëpër institucioneve shëndetësore, spitalore posaçërisht

në QKUK. Të gjitha këto propozime për lirime nga tatimet doganore dhe mallrat me tatim zero doganor janë rezultat i transparencës dhe konsultimeve të Ministrisë së Financave dhe komunitetit të biznesit. Këto lirime do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit poashtu edhe në jetën e qytetarëve tonë. Ministria e Financave ka qenë shumë e kujdesshme gjatë draftimit të ligjit përkatësisht të mallrave të cilat janë të liruar nga tatimi doganor. Ligji përveç që ka qëllim kryesor nxitjen e prodhimit ka për qëllim edhe mbrojtjen e prodhuesit.

Hykmete Bajrami theksoi se në listën e mallrave që janë liruar nga taksat doganore i kam shënuar disa të cilat mendoj që nuk jam shumë e sigurt për ndikimin që do ta kenë në zhvillimin ekonomik. E para në listë është nafta. Si do të ndikojë kjo në zhvillimin ekonomik? Pse nafta të lirohet nga taksa doganore? Nëse është menduar që me këtë të stimulohet sektori i bujqësisë ne e dijmë se një % shumë e vogël shkon për bujqësi kurse pjesa më e madhe është për veturat diesel, edhe nëse kësaj i largohet taksa doganore si do të siguroj Ministria se çmimi i naftës do të bije sepse kjo mund të ndikoj vetën në fitimin e pikave të karburantit? Nëse heqet taksa doganore për misër do të stimulohen importuesit por kjo do ti bëjë konkurenca prodhimit vendor. Kemi vaji, dmth fara të lulediellit edhe ky është një produkt final dhe nuk e di se pse duhet të hiqet taksa doganore, dhe a do të ulët çmimi? A keni mekanizma që do të ulen çmimet apo kjo do të ndikoj në ngritjen e mazhës së fitimeve të operatorëve ekonomik që merren me këto. Pastaj e shoh që lirohen tonerët dhe printerët, dhe në këtë aspekt besoj që do të rritet mazha e fitimit të këtyre kompanive që janë përfaqësues të këtyre produkteve edhe nuk kanë kurrfar lidhje me zhvillimin e informatikës. E kam edhe një pyetje. Goma në formë primare është si land e parë sigurisht nuk është fjala për gomat që i'u kemi hequr akcizë më herët? A është menduar për kafshët për llojet e tyre që nuk janë në Kosovë apo psh bletari është një sektor mjaft i suksesshëm në Kosovë dhe unë mendoj që nëse heqim taksën doganore ne po i bëjmë konkurenca këtij sektori.

Bedri Hamza sqaroi se qëllimi i heqjes së doganës për naftë ka qenë të heqim rolin monopolist të disa kompanive që operojnë në Kosovë në këtë fushë si dhe t'i trajtojmë barabartë me disa tjera. Përmes këtij projektligji është menduar të ndihmohet t'iu ulët kostoja disa barnave që përdoren në shëndetësi. Po ashtu të ulët kostoja për pajisje, në fabrika për konstruksione për lëndën e parë dhe të bëhet nivelizimi edhe trajtimi i barabartë me vendet nga e kanë origjinën ato produkte.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni me Një Abstenim (Hykmete Bajrami), asnjë Kundër dhe të gjithë anëtarët tjerë Për, nxori këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratoj në parim Projektligji nr.04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetarja nëse analizojmë projektligjin shohim se përmban implikime buxhetore shtesë, por se me nenin 20 është rregulluar se të gjitha dispozitat që përmbajnë implikime buxhetore shtesë do të zbatohen prej vitit 2016 pasi që të plotësohen kushtet financiare dhe ti bëhet një vlerësim i saktë i kostos financiare në implementimin e tij për këtë atë vit dhe periudhën vijues. Megjithatë janë edhe dy nene 4 dhe 19 që përmbajnë implikime buxhetore e që nuk janë përfshirë në kuadër të nenit 20, dhe propozojë që ne të rekomandojmë që të futen në kuadër të nenit 20. Amendamentet e komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni me Një Abstenim (Hykmete Bajrami), asnjë Kundër dhe të gjithë anëtarët tjerë Për, nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr.04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, më përjashtim të nenit 4 dhe nenit 19.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendamentin si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 20, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Dispozitat e neneve 3, 4, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 16, 17, 19 dhe 20, fillojnë së zbatuari nga viti 2016, nëse krijohen kushtet financiare dhe pas një vlerësimi të saktë të kostos financiare në periudhën vijuese.

5. Të ndryshme

Kryetarja theksoi se desha të diskutoj për qasjen që do ti bëjmë projektbuxhetit. GIZ bashkarisht me stafin dhe në konsultim edhe me mua e kemi përgatitur një plan veprimi për organizimin e takimeve dhe dëgjimeve buxhetore të grupeve punuese dhe komisionit. Mendojë që pasiq që kemi shumë institucione të pavarura, do të ishte mirë që disa institucione të pavarura të fillojmë që nga e java e ardhshme ti thërrasim grupe punuese dhe ti dëgjojmë për kërkesat buxhetore dhe buxhetin e tyre. Qëllimi është që të ftohen të gjithë institucionet dhe agjencionet e pavarura që i raportojnë Kuvendit dhe të organizojmë dëgjime buxhetore me ato. Ndërkaq pas miratimit në Kuvend të projektligjit për buxhetin, ne do marrim vendimet dhe nxjerrim rekomandimet për Kuvendin. Po ashtu njoftoi se stafi që mbështetë komisioni ka përgaditur follderat për të gjithë anëtarët dhe aty do të jenë të gjitha kërkesat dhe raportet nëntëmujore të agjencioneve të pavarura për këtë vit që përmes një shkrese iu është kërkuar ti dorëzojnë në komision deri më datën 7 të këtij muaji dhe iu është kërkuar ti paraqesin sipas formularëve që i kemi hartuar si komision. Po ashtu të gjithë këtyre agjencioneve të pavarura dhe institucionet që kanë dorëzuar deri më tani kërkesa buxhetore në komision, i kemi kontaktuar dhe iu kemi thënë se afati për paraqitjen e kërkesave shtesë buxhetore është deri më 15 nëntor dhe iu kemi kërkuar ti paraqesin sipas formularëve standard të përgaditur. Por ndoshta edhe kësaj radhe do të përballemi me kërkesa që vijnë më vonë deri sa të futet e tërë puna jonë në sistem, por megjithatë ne duhet t'a respektojmë rregulloren e Kuvendit, e cila kufizon afatin prej 10 ditë pas miratimit të projektligjit në parim në Kuvend, për paraqitjen e amendamenteve apo në këtë rast kërkesave buxhetore.

Mbledhja përfundoi: 12:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona